



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°19/2022

Hagë, 19/05/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Dje, më 18 maj, Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore të z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj shqiptoi aktgjykimin. Ky është aktgjykimi i parë i lëshuar prej një trupi gjykses në DHSK.

Trupi Gjykses i shpalli z. Gucati dhe z. Haradinaj fajtorë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës. Këto janë shkelje të Kodit Penal të Kosovës dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Trupi Gjykses i shpalli të akuzuarit të pafajshëm lidhur me hakmarrjen. Trupi Gjykses dënoi secilin prej të akuzuarve me burgim katër vjet e gjysmë, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe me gjobë 100 euro.

Trupi Gjykses konstatoi se në tri konferenca për shtyp, në më shumë se 20 paraqitje në media të tjera dhe përmes postimeve në mediat sociale, të akuzuarit zbuluan informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarë të mbrojtur dhe dëshmitarë të mundshëm. Ata i ekspozuan dokumentet që përmbanin atë informacion; lejuan të tjerë të këqyrnin, filmonin, fotografonin, kopjonin ose merrnin me vete dokumentet dhe përshkruan publikisht përmbajtjen e dokumenteve.

Krahas këtyre veprimeve, Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit publikisht i quajtën dëshmitarët “tradhtarë”, “spiunë”, “bashkëpunëtorë” dhe “shqipfolsa”, me synimin për t'i frikësuar dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm dhe rrjedhimisht për t'i bërë që të ngurronin të jepnin informacion.

Gjatë shqiptimit të Aktgjykimit, Trupi Gjykses theksoi se kjo çështje ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e proceseve gjyqësore

1





Informimi javor për median Dhomat dhe Zyra Administrative

N°19/2022

Hagë, 19/05/2022

dhe sigurinë, mirëqenien dhe çlirimin nga frika të qindra personave, të cilët janë paraqitur për të përmbushur detyrën e tyre qytetare si dëshmitarë. Mbrojtja e dëshmitarëve nga frikësimi dhe dëmtimi qëndron në themelin e çdo sistemi të drejtësisë penale, qoftë ai vendor apo ndërkombëtar. Trupi Gjykes i përshkroi veprimet e të akuzuarve si sfidë ndaj atij themeli dhe për rrjedhojë si kërcënim për drejtësinë.

Përmbledhja e Aktgjykimit si edhe versioni i redaktuar publik i plotë i tij gjenden në faqen e Dhomave të Specializuara në internet. Seanca mund të shihet në kanalën e DHSK-së në *YouTube*.

Javën e shkuar Zyra Administrative organizoi një vizitë si i paraburgosur të Hysni Gucati në Kosovë për arsye humanitare bindëse, për të takuar familjen e ngushtë, në pajtim me një vendim të Trupit Gjykes. Gjatë vizitës, Z. Gucati ishte i paraburgosur dhe nën ruajtjen e Dhomave të Specializuara të Kosovës. Versioni i redaktuar publik i vendimit të Trupit Gjykes në lidhje me vizitën gjendet në faqen e Dhomave të Specializuara në internet.

Gjykimi i z. Salih Mustafa vazhdoi këtë javë me mbajtjen e një seance ditën e sotme. Trupi Gjykes ka caktuar të enjten, 26 maj si datë të synuar për mbylljen e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.

Në çështjen e z. Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarve, konferenca e dymbëdhjetë mbi ecurinë e çështjes është caktuar për ditën e nesërme, e premte, 20 maj, në orën 14:30. Rendi i ditës përfshin tema si procesi i nxjerrjes së materialeve, hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e ardhshëm dhe propozime për përmirësimin e efikasitetit procedural të çështjes.

Të gjitha seancat publike të Dhomave të Specializuara të Kosovës transmetohen në internet dhe mund të përcillen në shqipe, serbishte ose anglishte.

Pyetje nga gazetarët

2





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°19/2022

Hagë, 19/05/2022

Nuk pati pyetje

